



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
AGJENCIA SHQIPTARE E ZHVILLIMIT TË INVESTIMEVE

SHPALLJE VENDI VAKANT PËR POZICIONIN:
SPECIALIST
SEKTORI I INVESTIMEVE DHE AFTER CARE/DREJTORIA E
INVESTIMEVE

1. TË DHËNAT PËR POZICIONIN E PUNËS:

Emërtesa e pozicionit: Specialist

Klasa e pagës: IV-1

Drejtoria: Drejtoria e Investimeve

Raporton te: Përgjegjësi i Sektorit të Investimeve dhe After Care

2. QËLLIMI I PËRGJITHSHËM I POZICIONIT: Specialisti i Sektorit të Investimeve dhe After Care përgjigjet te Përgjegjësi i Sektorit të Investimeve dhe After Care dhe te Drejtori i Drejtorisë së Investimeve për zhvillimin e nxitjes së investimeve të huaja, duke u fokusuar në kompanitë e targetuara, të cilët ia propozon Përgjegjësit të Sektorit të Investimeve dhe After Care, me qëllim për t'i kthyer në projekte për investime konkrete në Shqipëri.

Specialisti i Sektorit të Investimeve dhe After Care ndihmon në hartimin e politikave për investimet e huaja me synim forcimin e klimës së biznesit, duke marrë të dhëna nga investitorët që kanë shprehur interes për të investuar në Shqipëri..

3. DETYRAT KRYESORE:

- Mbledh dhe përpunon informacion, në kuadër të identifikimit të investitorëve të synuar në sektorët strategjikë, si dhe asiston në përcaktimin e grupeve të targetuara;
- Kontribuon në krijimin dhe mirëmbajtjen e një baze të dhënash me kompanitë e targetuara ndërkombëtare me të dhënat e nevojshme të kontaktit;
- Vendos komunikime me grupet e targetuara, për t'i inkurajuar ato për të investuar në Shqipëri;

- Kontribuon në drejtim të zhvillimit të fushatave promociionale për nxitjen e investimeve, duke u fokusuar në kompanitë e targetuara, me qëllim promovimin e avantazheve që ofron Shqipëria për investitorët potencialë, krahasuar këto me vendet e rajonit;
- Kontribuon në realizimin e publikimeve dhe kërkimeve për sektorët prioritarë;
- Kontribuon në drejtim të përditësimit në mënyrë të vazhdueshme të materialeve promovuese.

4. KUSHTET QË DUHET TË PLOTËSOJË KANDIDATI

Kushtet e përgjithshme që duhet të plotësojë kandidati janë:

- a - Të jetë shtetas shqiptar;
- b - Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- c - Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
- d - Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- e - Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;
- f.- Ndaj tij të mos jetë marrë asnjë masë disiplinore gjatë 6 muajve të fundit të periudhës kohore të punës. *(Nëse është në marrëdhënie pune në sektorin publik)*

5. KËRKESAT E POSAÇME:

Arsimi minimal: Master profesional në shkenca juridike/marrëdhënie ndërkombëtare/ekonomike. Diplomat, të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë njohur paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave, sipas legjislacionit në fuqi.

Përvoja: Të ketë paktën 3 (tre) vite eksperiencë pune.

Tjetër: Të ketë njohuri në fushën e metodave kërkimore, që ndihmojnë në përgatitjen e raporteve bazike dhe/ose analitike. Të ketë aftësi për të integruar informacionin me politikat institucionale. Të ketë aftësi për të identifikuar dhe qartësuar çështje, si dhe për të dhënë mendime alternative të mbështetura në përvojën profesionale. Të ketë aftësi për të vlerësuar opsione politikash dhe për të parashikuar pasojat nga përzgjedhja e tyre. Të ketë njohuri të gjuhës angleze; njohja edhe e gjuhëve të tjera përbën avantazh.

6. DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

- a - Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me standardet e legjislacionit shqiptar në gjuhën shqipe;
- b - Fotokopje të diplomës. Për diplomat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë të përcillet njehsimi nga Ministria e Arsimit dhe e Sportit;
- c - Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- d - Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- e - Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- f - Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;
- g - Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;

Aplikimi dhe dorëzimi i të gjitha dokumenteve të cituara më sipër, do të bëhet nëzyrën e protokollit të institucionit me adresë: **Rruga “Skerdilajd Llagami”, Nd.1, H.6, Tiranë** ose në adresën zyrtare të e-mailit: **info@aida.gov.al**

Kandidatët e interesuar paraqesin kërkesën për aplikim, dokumentacionin si më sipër dhe dokumentacionin vërtetues për kriteret e përgjithshme dhe të posaçme brenda datës: **(20.11.2023 afati i fundit i aplikimit)**

7. REZULTATET PËR FAZËN E KONKURRIMIT

Në vijim, AIDA do të realizojë:

- 1- Fazën e parë të konkurrimit e cila konsiston në verifikimin e dokumentacionit të dorëzuar nga njësia përgjegjëse për menaxhimin e burimeve njerëzore;
 - a- Nëse dokumentacioni i paraqitur nga çdo kandidat vërteton plotësimin e kërkesave të përgjithshme dhe të veçanta në shpalljen për konkurrim.
 - b- Nëse kandidatët plotësojnë kërkesat e përgjithshme dhe të veçanta të vendit të punës;
- 2 - Faza e dytë e konkurrimit është faza e intervistimit të punonjësve të kualifikuar nga komisioni. Në këtë fazë komisioni bën një vlerësim të formimit të përgjithshëm të kandidatëve si dhe vizionit të tyre personal në lidhje me veprimtarinë e AIDA-s.

8. MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Në përfundim të fazës së dytë komisioni i përzgjedhjes bën një vlerësim me pikë. Totali i pikëve të vlerësimit të kandidatëve është 100 pikë.

Për vlerësimin e kandidatëve, secili anëtar jep pikët e tij. Në përfundim pikët e grumbulluara mbledhen. Shuma e pikëve të mbledhura nga të gjithë anëtarët pjesëtohet me numrin e anëtarëve të tij dhe kjo vlerë përbën rezultatin përfundimtar.

Komisioni i Përzgjedhjes jep vlerësimin e tij sipas rregullores mbi kandidatët potencialë për punësim duke e shoqëruar me një raport përmbledhës.

Raporti përmbledhës së bashku me listën e 3(tre) kandidatëve që kanë arritur rezultate më të larta i paraqitet Drejtorit Ekzekutiv brenda një afati 5 (pesë) ditor nga përfundimi i vlerësimit.